



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 14, datë 30.03.2020

PËR

**DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN”, TË DY AMBJENTEVE: S1 = 79.1M<sup>2</sup> DHE S2 = 90.4 M<sup>2</sup>, TË NDODHURA NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR.PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 3 VJET, PËR T’U PËRDORUR “PËR SHËRBIME DHE MBËSHTETJE SOCIALE E KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE, PËR NISMA NË MBËSHTETJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE, ARSIMIT, EDUKIMIT, PUNËSIMIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PËR INFORMIMIN, NDËRGJEGJËSIMIN, INTEGRIMIN, BASHKËJETESËN KOMUNITARE DHE DIALOGUN SOCIAL”**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 197, datë 10.07.2014, që bën fjalë për kalimin e sip.2.233 m<sup>2</sup> për ndërtimin e apartamenteve sociale, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, kërkesës së Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, e protokolluar me nr. 2189 prot., datë 13.02.2020, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetarit Bashkisë z.Zhuljen Varfaj, i cili kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtëpërblim, Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, të dy ambjenteve: S1 = 79.1 m<sup>2</sup> dhe S2 = 90.4 m<sup>2</sup>, të ndodhura në katin e parë të banesave sociale, me nr.pas. 5/270, ZK 8513, lagja nr. 17, rruga “Dalip Peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 3 vjet, për t’u përdorur “Për shërbime dhe mbështetje sociale e kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore, për nisma në mbështetje të shërbimeve publike, arsimit, edukimit, punësimit e zhvillimit ekonomik dhe për informimin, ndërgjegjësimin, integrimin, bashkëjetesën komunitare dhe dialogun social”.



2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore pranë Bashkisë Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

### KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.03.2020